



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

VENDIM

Nr. 1 Data 03.10.2017

Për miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit uJOR në ujërat e lumit te Gugashit, degë e djathtë e lumit Kardhiqit, për ndërtimin e hidrocentralit "Kaparjel" për prodhim të energjisë elektrike, Rrethi Gjirokaštër, Qarku Gjirokaštër, subjektit " ABV - Konstruksion" sh.p.k., me administrator Z. Arlind Veliu

Në bazë të ligjit Nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të V.K.M 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit Nr. 876, datë 14.12.2016 "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit Nr. 662 datë 21.09.2016 "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit UJOR", Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit UJOR"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni",

VENDOSI

Miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit uJOR në ujërat e lumit te Gugashit, degë e djathtë e lumit Kardhiqit, për ndërtimin e hidrocentralit "Kaparjel" për prodhim të energjisë elektrike, Rrethi Gjirokaštër, Qarku Gjirokaštër, subjektit " ABV - Konstruksion" sh.p.k., me administrator Z. Arlind Veliu me këto të dhëna:

Koordinatat: X 4410578.28; Y 444217.01; Z 495

Prurja mesatare: 0.5 m3/sek

Prurja e llogaritur: 0.65 m3/sek

Prurja e ekologjike: 0.08 m3/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritetet të jetë **200 kW**

Afati i autorizimit 1 vit.

Për përdorimin e këtij burimi ujq duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e autorizimit.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"

Ilir PROEKA



KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Etjona HOXHA

